

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Bashkia Krujë
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr 143 Datë 18/102017

AKT

**MBI AKTIN E KONFORMITETIT TË HARTIMIT DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË DETAJUAR VENDOR
Njësia strukturore NI-UB-021**

Këshilli i Bashkisë Krujë, në mbledhjen e tij të datës 18/10/2017 pasi mori në shqyrtim njoftimin nga Kryetari i Bashkisë për ndërrmarrjen e nismës për hartimin e Planit të Detajuar Vendor, Njësia strukturore NI-UB-021, bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pikës 1, shkronja “b”, të nenit 13, në Vkm Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, në VKM Nr.671, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, i ndryshuar, në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Krujë, në nenin 18 të Rregullores Vendore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Udhezimin Nr. 7938, date 17.7.2014 “Per percaktimin e tarifave dhe vlerave perkatese per sherbimet qe kryhen ministria e Mjedisit per procesin e VNM-se me synim zhvillimin e kësaj njësie strukturore bazuar në kërkesat e komunitetit për investime si dhe ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës, me votim të hapur dhe me konsensus:

VENDOSI:

1. Të miratojë Konformitetin e Nismës për hartimin dhe miratimin e Planit të Detajuar Vendor, Njësia strukturore NI-UB-021 sipas dokumentacionit shoqërues :
- Nisma për hartimin dhe miratimin e Planit të Detajuar Vendor, Njësia strukturore NI-UB-021
 - Dokumentacioni i Nismës për hartimin dhe miratimin e Planit të Detajuar Vendor, Njësia strukturore NI-UB-021
 - Relacioni

Sekretar i Këshillit

Maliq Recit



Kryetar i Këshillit

Hysni Caca

